



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.950/20
956/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Matcal Solutions” SHPK- Prishtinë dhe OE “Construmax” SHPK - Suharekë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-20-3261-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL PRIZREN, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Matcal Solutions” SHPK- Prishtinë dhe OE “Construmax” SHPK - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-20-3261-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL PRIZREN.

II. ANULOHET, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-20-3261-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL PRIZREN, dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Matcal Solutions” SHPK- Prishtinë, si dhe OE: “Construmax” SHPK - Suharekë, aprovohen si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Matcal Solutions” SHPK- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 16.11.2020 me nr. 950/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-20-3261-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL PRIZREN, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 64, 66 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues “Construmax” SHPK - Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 17.11.2020 me nr. 956/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit” me nr. të prokurimit: 622-20-3261-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL PRIZREN, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 62 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-

ankues sqaron si në vijim:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket vlerësimeve të pretendimeve të OE ankuesit "Matcal Solutions" SHPK fillimisht sqaron se, ky aktivitet i prokurimit ka filluar me datën 29.06.2020 Njoftimi për kontratë, ku hapja e ofertave është bërë më datën 20.07.2020, ku AK pas vlerësimit të ofertave ka dal me njoftimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit, me datë 31.08.2020 me arsyetimin se nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme, të njëjtën kohë kemi pranuar ankesa nga po të njëjtit OE ankues të cilët kanë qenë kundër anulimit duke pretenduar se i plotësojnë kriteret dhe se janë të përgjegjshëm. Më datë 09.10.2020 OSHP nxjerr vendimin PSH.654-702/20 ku aprovohen ankesat e OE ankues pjesërisht dhe lënda kthehet në rivlerësim. Me datë 30.10.2020 nga AK është bërë rivlerësimi dhe i njëjti prapë vendosë që të anulohet aktiviteti i prokurimit me të njëjtën arsye "nuk ka oferta të përgjegjshëm" po ashtu ofertuesit i eliminon me të njëjtat arsye!

OE ankuesi "Matcal Solutions" SHPK ankohet se është eliminuar padrejtësisht dhe se pretendon se është e përgjegjshme.

I njëjti eliminohet me arsyetimin:

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :ju mungojn ;

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 € (referenca e juaj ka vlerën prej 256,891.00€.

Ekspertja Shqyrtuese tutje sqaron se, sa i përket pretendimit të OE ankuesit, ne kemi shqyrtuar pretendimin e të njëjtit, mirëpo gjatë procesit të rivlerësimit sipas vendimit të PSH 654-702/20 -AK kishte kërkuar sqarim me shkrim nga OE ankuesi, dhe meqë nuk ishte në e-prokurim e bashkangjitur përgjigja e kërkesës për sqarim nga OE, atëherë kërkuam sqarim nga AK me e-mail:

I nderuar,

Jemi duke e shqyrtuar ankesën e OE ankuesit "**Matcal Solutions**" SHPK për Aktivitetin e Prokurimit me titull "Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit" me nr të prokurimit 622-20-3261-5-2-1.

Gjatë procesit të rivlerësimit ju keni kërkuar sqarim nga OE në fjalë, duke kërkuar paramasën për kontratën **632-16-081-521 te Drini Company**, ne nuk e gjetëm në e-prokurim përgjigjen e OE ankuesit lidhur me këtë sqarim!

A keni pranuar përgjigje mbrapa për këtë sqarim nga Operatori Ekonomik apo jo?

Me shpresë se na përgjigjeni me prioritet,

Faleminderit për bashkpunim,

Me respekt,

Blerina Huruglica

Eksperte Shqyrtuese

OSHP

Ekspertja Shqyrtuese tutje sqaron se AK na është përgjigjur e-mailit po të njëjtën ditë:

Isa Osmankaj

Inbox

To: Blerina Huruglica;

Përshëndetje e nderuar. Kontrata në fjalë është kërku dhe është sjellë nga OE në zyren e Prokurimit. Kjo kontratë ndodhet në landën përkatëse e cila është në shqyrtim në OSHP.

Për të iu lehtësu juve punën, pozicionet të cilat janë marrë sit ë natyrës së kontratës janë të markuara me ngjyrë në këtë kontratë

Nëse keni paqartësi më merrni në telefon iu lutem

03820044704

045479629

Isa Osmankaj

Komuna e Prizrenit

Tutje Ekspertja sqaron, në email AK sqaron se OE ankuesi ju ka përgjigjur kërkesës për sqarim dhe i njëjti ka dërguar fizikisht dëshmitë e kërkuara:” Paramasën për kontratën me nr 632-16-081-511- Ndërtimi i rrugës Bujar Roka”, ku AK ka vlerësuar se nuk i plotëson kriteret kontrata, gjersa gjatë shqyrtimit dhe analizimit të paramasës së kontratës mendoj se kjo kontratë/paramasë i plotëson kriteret, andaj rekomandohet AK që të bëjë edhe njëher rivlerësimin e ofertave, dhe të vlerësoj detajisht kontratat dhe paramasat.

Shih më poshtë vendimi PSH. 654-702/20:

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK pa drejt e ka eliminuar me arsyen se OE ne fjale nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së pika III.2.4 tek Kapacitetet teknike dhe profesionale.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues pas verifikimit dhe analizimit të pretendimit të OE ankuesit “Matcal Solucion” SHPK konstaton se ky pretendim i parë i OE ankues qëndron pjesërisht i bazuar, për arsye OE ankuesi i ka plotësuar kriteret sipas FDT-së dhe NJK. Kjo nga fakti se Kërkesa në FDT ka qenë:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmita e kërkuar dokumentare:
Kërkesa 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300,000.00 € Kërkesa 2 a. Në kundërt të stafti duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë i ngjitur i diplomuar i	Dëshmita 1. Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e shkruar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimiit përfundimtar të punëve. Dëshmita 2. Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmita mbi përvojën në punë, dëshmita mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose

B05 Njoftim per Kontrat

4 / 7

Dhe se OE ankues vetëm me kontratën të cilën e kemi përmendur “Ndërtimi i Rugës Bujar Roka” sipas referencës e përmbushni këtë kërkesë të AK-së, gjersa listën e projekteve nuk e keni të kompletuar (mungon nr. i AP) siç kërkohet, por që AK sipas nenit 72 të LPP-së, mund që të kërkojë informata sqaruese.

Përderisa sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit të dytë “Construmax” SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, siq sqaruam në fillim tek OE ankuesi i parë, e që vlenë të theksohet më tepër tek OE ankuesi “Construmax” SHPK, te ky i fundit gjatë shqyrtimit të ankesës tij ka ndodhur një gabim teknik nga ana ime gjatë shkarkimit të ofertave nga e-prokurimi, ku dëshmitë nuk janë vërejtur dhe ne si OSHP kemi shqyrtuar ankesën me gjysmën e dokumenteve, dhe si pasojë e mbajtjes së seancave dëgjimore pa pranin e palëve ky keqkuptim/devijim i cili ka vazhduar deri në vendim, derisa në këtë ankesë ankuesi na ka sqaruar se edhe ku mundemi me i gjetë dëshmitë në ofertë!.

OE ankuesi është i eliminuar me arsyetimin:

- të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper
- një eskavator I tonazhit të mesëm deri 10 ton (eskavator ton i madh)
- OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhuesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

Pretendimi i parë i OE ankues është:

Pretendimi 1: Kompania jonë supozon që nuk qëndron arsyeja e eliminimit të kompanisë tonë kinse nuk kemi në pronësi pajisje teknike së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 - 10 tonë me kiper, Kompania jonë ka dorëzuar së bashku me dokumentacionin e ofertës tek **folderi 7.1 Makineri**

Imri Krasniqi — Libreza e kamioni me tonazh 8.2 tonë me regjistrim deri 04.09.2020 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Isuf Misini - Libreza e kamioni kiper me tonazh 8.1 tonë me regjistrim deri 31.07.2020 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Ebk shpk- Libreza e kamioni kiper me tonazh 5.05 tonë me regjistrim deri 06.05.2021 (hapja e

ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Shaban Aliu - Libreza e kamioni kiper me tonazh 5.57 tonë me regjistrim deri 20.06.2021 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Andaj arsyeja e eliminimit është totalisht e pabaze, pasi që jo vetëm që ne i kemi 4 kamion a ndërsa kërkesa ka qenë 2 kamion dmth dyfishin e kërkuar plotësojmë

Ekspertja Shqyrtuese gjatë shqyrtimit të pretendimit në ofertën e OE ankues, tek folderi 7.1 Makineritë sqaron se e plotëson kriterin - dy kamion të tonazhit 5 10 ton me kiper. Andaj pretendimi gjendet i bazuar.

Po i bashkangjesim dëshmitë vetëm për dy, siç kërkohet në FDT, gjersa OE ka edhe të tjerë siç pretendon më lartë:

Imri Krasniqi

Suharekë
Fsh. Reshtan
Tel: 049/723761
Nr. leter: 1030634752

Construmax SH.P.K

SUHAREKË
Adresa: Rr. Mentor Krasniqi p.n. fsh. Bukosh - Suharekë
Tel: 049/137-004
NUI: 811273739

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË KAMION ME KRAN ME 2 DYER

Neni 1.

Duke u bazuar në kushtet e punës ndërtimore dhe bashkpunimin e ndërmarrjeve të lartëpërmendura lidhin marrvëshje mbi dhënie në shfrytëzim të mjeteve të punës

Neni 2.

Imri Krasniqi - Suharekë me numër te leternjoftimit : **1030634752** i jepë në shfrytëzim **Construmax SH.P.K** - Suharekë Kamion me kran 2 Dyer, Për të kryer punët sipas nevojës së ndërmarrjes **Construmax SH.P.K** dhe kohës kur i nevojitet kësaj ndërmarrje.

Koha e skadimit të kësaj kontrate parashihet të jetë në 01.06.2021 sipas nevojës mundet edhe të zgjatet afati kohor

A	Nomer i regjistrimit Ipri personajve Registration number	04-709-DQ
I	Data e regjistrimit Data personajve Date of registration	05-09-2019
C	Të dhëna personale Data personajve Personal data	
C.2	Emri i njeriut Person's name Owner of the vehicle	
C.2.1	Mënyra e punës Mënyra e punës Manner of work	Krasniqi
C.2.2	Emri Emri Name	Imri
C.2.3	Adresa Adresa Address	Suharekë Suharekë
B	Data e regjistrimit të punës Data e regjistrimit të punës Date of the registration	07-06-1999
D	Adresa Adresa Address	
D.1	Prodhuesi Prodhuesi Manufacturer	MECO
D.2	Tipi Tipi Type	Magirus
D3	Nomeri i kamionit Nomeri i kamionit Commercial registration	190 E
E	Nomeri i kamionit Nomeri i kamionit Commercial registration	190 E
S	Vendi i prodhimit Vendi i prodhimit Place of production	1999
S	Emri i kamionit Emri i kamionit Registered registration	
S.1	Nomeri i kamionit Nomeri i kamionit Registered registration	2
S.2	Nomeri i kamionit Nomeri i kamionit Registered registration	
Q	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	
F	Kapaciteti Kapaciteti Capacity	18000
F1	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	8200
G	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	9800
K	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	
P	Adresa Adresa Address	
P1	Kapaciteti i punës Kapaciteti i punës Capacity of work	7790
P2	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	
P3	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	Dizel
R	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	E Bardhë
2A	Tipi i kamionit Tipi i kamionit Type of vehicle	Kamion me Kran 2 Dyer

CRA/YPB/VRC 1441425



Pretendimi 2: Kompania jonë supozon që nuk qëndron arsyeja e eliminimit të kompanisë tonë kinse nuk e kemi një eskavator I tonazhit të mesëm deri 10 ton (eskavator ton i madh), pasi që është dorëzuar me ofertë tek folderi 7. Makineria - seti Comercv-6.2 Bagerat 5 cope- ku brenda kësaj fajlli në faqen e 16 është dudi doganor me nr reference doganore R 11616 që dëshmon Eskavator i perd me zingjir gime me peshë 5.5 tonë i tipit VQLVO tipi EC55B viti i prodhimit 2006.

Andaj arsyeja e eliminimit është totalisht e pabaze, pasi që përpos disa ekskavatorëve të dëshmuar kemi ofruar edhe dëshmi që kemi edhe eskalator prej 5.5 tone i prodhimit Volvo tipi EC 55 B 2006.

Ekspertja Shqyrtuese gjatë shqyrtimit të pretendimit të OE ankuesit në ofertën e tij tek follderin 7. Makineria, sqaron se ky pretendim gjendet i bazuar, me faktin se gjendet Dudi doganor faqe 16 tek Seti Commerce 6.2

Pretendimi 3: Kompania jonë supozon që nuk qëndron arsyeja e eliminimit të kompanisë tonë kinse OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Kompania jonë ka dorëzuar së bashku me oferte folderin 9. Autorizimi nga prodhuesi - ku mbrenda është Autorizimi nga prodhuesi Europa shpk me NIPT J62903258L nga Shqipria ku jemi autorizuar nga ky prodhues që ka dëshmuar në autorizimin e tij që është i certifikuar më këto standarde dhe koperon më kompani tjera ndërkombëtare më standarde tjera.

Andaj konstatojmë që ne kemi ofruar dëshmi Autorizimin e Prodhuarit sipas kërkesës në dosje të tenderit, ndërsa në rast që Autoriteti Kontraktues ka dashur dëshmi tjera shtesë do të duhej konform

nenit 72 të kërkoj sqarime edhe pse ka pasur dëshmi të mjaftueshme që kemi autorizim nga prodhuesi me këto standarde.

Ekspertja Shqyrtuese po ashtu pretendimin e OE ankuesit e gjënë të bazuar, sepse në ofertën e tij tek follderi 9 gjendet Autorizimi nga prodhuesi, andaj pretendimi gjendet i bazuar, dhe se AK rekomandohet që gjatë procesit të rivlerësimit të verifikoj me kujdesë certifikatat sipas FDT-së.



Europa shpk
NIPT J62903258L
Adresa : Ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan

AUTORIZIM NGA PRODHUESI

Titulli i projektit: "Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit"

Me numër të prokurimit: 622-20-3261-5-2-1

Me numër të brendshëm: 622-20-073-521

Autoriteti kontraktues: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

Në Europa SH.P.K me NIPT J62903258L me seli Ish Kombinati Metalurgjik Bradashesh Elbasan, Shqiperi, me administrator Thanas Rula ,prodhues/përpunues i metaleve , jap këtë autorizim prodhuesi për **Construmax SH.P.K me NUI 811273739** me seli në Rr.Mentor Krasniqi p.n. Bukosh-Suharekë për projektin "Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit" me numër të prokurimit 622-20-3261-5-2-1 dhe numër të brendshëm 622-20-073-521 .

Në konfirmojmë që në procesin e prodhimit special me materiale të çelikut S235JR (1.00038 EN) në koepërojmë me Manispre spa nga Italia, shoqëria jone Europa shpk operon konform me standardin e saldimit EN 15609-1 , si dhe për galvanizim me bashkëpunojmë me Selmani sh.p.k. që realizon galvanizimin konform standardit ISO 1461.

Europa shpk
Administrator Thanas Rula

Pretendimi 4: OE NNT Etniku nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së tek Kapaciteti teknik dhe profesional. Ky OE është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar dëshmi që ka në pronësi ose posedim këto pajisje teknike: **a)** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper **b).** një eskavator I tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda të cilat nuk janë adekuate për këtë projekt. Gjithashtu ky OE nuk ka prezantuar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar

i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461, mirëpo ka prezantuar një marrëveshje për të cilën nuk ka dëshmi që është Kompani e certifikuar apo distributor, andaj edhe është i papërgjegjshëm dhe Pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin e këtij OE.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të OE ankuesit lidhur me OE NNT Etniku, konsideron se pretendimet janë të qëndrueshme, për faktin se në ofertën e OE Etniku kërkesa 3 tek kapacitetet teknike dhe profesionale nuk i plotëson kriteret pasi që kamionët/eskavatorin i ka jashtë kriterit të FDT-së.

Pretendimi 5: OE N.N. " Injineriing MSH " TOSI - V " SH.P.K. është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ky OE ka kryer punime te ngjashme 60% të vlerës si lider. Po ashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi që ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a). së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton 3. me kiper b. një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda që nuk janë adekuate për këtë projekt. Ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. OE ka paraqit vetëm një a test te materialit në një kompani që nuk i ka certifikatat të cilat janë kërkuar dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkesë ka qenë "Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qene prej jo më pak se 400.000,00 €", ndërsa si dëshmi është kërkuar "Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës." Lideri i konzorciumit të lartpërmendur nuk i ka ofruar dëshmitë se e plotëson këtë kërkesë andaj edhe është i papërgjegjshëm.

Ekspertja Shqyrtuese pretendimet e OE ankuesit për OE NNT "Injineriing MSH" "Tosi-V" SHPK, sa i përket Lista e punimeve të ngjashme si lider, lideri ka bashkangjitur një listë me shumën 287,555.44 Euro, mirëpo mendoj se punimet nuk janë ngjashme, po ashtu pajisjet si kamionet i ka nen dhe mbi tonalitet dhe njëra pa regjistrim, eskavatori nuk ka DUD, andaj pretendimi i OE ankues konsideroj se është i qëndrueshëm.

Pretendimi 6: "Puna" Sh.p.k nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së tek Kapaciteti teknik dhe

profesional. Ky OE është i papërgjegjshëm për faktin se ky OE nuk i ka ofruar dëshmitë në lidhje me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit.

Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kryer punë të ngjashme sipas kërkesës së dosje të tenderi edhe pse ka paraqitur disa referenca private, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi bankare që janë ekzekutuar vlerat e tyre. Po ashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi se ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike **a.** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper **b.** një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda të cilat nuk janë adekuate për këtë projekt.

OE i lartcekur nuk e ka ofruar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Ky OE ka paraqitur vetëm një a test të materialit nga një kompani që nuk i posedon certifikatat e kërkuara dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Ekspertja Shqyrtuese pretendimin e OE ankues për OE "Puna" SHPK e konsideron të qëndrueshëm, me faktin se tek kërkesa 3 Kapacitetet Teknike Profesionale, pajisjet i ka mbi tonalitet, po ashtu edhe kërkesën për autorizimin nuk i posedon sipas kritereve.

Pretendimi 7; N.T.P; B-Ademaj është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshjet e prezantuara për stafin profesional i ka të paraqitura për një projekt tjetër "Ndërtimi i objektit të ri të shkollës në fshatin Pllanjane. Gjithashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi se i ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisjeteknike **a.** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper **b.** një eskavator 1 tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda që nuk janë adekuate për këtë projekt.

Ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ka të paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461 dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Ekspertja Shqyrtuese pretendimin e OE ankues për OE NTP "B-Ademaj" e konsideron të qëndrueshme, duke u bazuar në ofertën e OE "B-Ademaj" ku i njëjti nuk e plotëson kërkesën 3 tek Kapacitetet teknike dhe profesionale.

Pretendimi 8: GOE Matcal Solutions & Drini Company është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dëshmi që e plotson kërkesën në dosje të tenderi „Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës” dhe bartësi I grupit nuk ka arrit të dëshmoj asnjë referencë.

Po ashtu ky GOE nuk ka dëshmi as që e plotsojnë vlerën e referencave prej 300.000 € dhe pajtohem me eliminimin e këtij konzerciumi nga AK-ja.

Eksperti Shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues kundër GOE"Matcal Solutions dhe Drini Company" nuk qëndron për faktin se Lideri i grupit ka bashkangjitur në ofertën e tij listën e punëve të ngjashme, mirëpo nuk është e pranuar si e mirëqenë nga AK.

Pretendimi 9: të gjithë OE tjerë janë të papërgjegjshëm dhe pajtohem me eliminimin e tyre nga AK-ja. Ekspertja Shqyrtuese pretendimin e nëntë e gjënë pjesërisht të qëndrueshëm.

Pretendimi 10: Ne me dt. 09.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka hedhur poshtë si e jashtëafatshme është e paqëndrueshme pasi që ne kemi dërguar kërkesën për rishqyrtim me datë 04.11.2020 në ora 15:56 ndërsa sistemi nëse e ka vonuar procesimin duhet sqaruar nga e-prokurimi, edhe pse Autoriteti Kontraktues ka mundur të shqyrtoj kërkesat për rishqyrtim pasi që nuk është e cekur në nenin 108/A ditë pune mirëpo kërkesa për rishqyrtim duhet të bëhet mbrenda 5 dite pas Vendimit që dmth që ditë kalendarike që përfundojnë në orën 0:00 dhe ka pasur afat kohor edhe 8 orë. Edhe nëse do të llogaritej ditë pune atëherë kemi pasur afat edhe 2 ditë tjera për arsye të ditës së shtune dhe të diel.

Andaj bazuar që kërkesa për rishqyrtim konform nenin 108/A duhet të bëhet më së largu 5 ditë pas Vendimit, me të pa drejt AK ka hudhur si të jashtëafatshme kërkesën për rishqyrtim.

Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Andaj nuk ceket ditë pune e as ora mirëpo ceket 5 ditë pas datës, që dmth data ndërrohet në ora 00:00 (12:00 i mbrëmjes) dhe kemi pasur afat deri në orën 00:00 edhe pse ne kemi dorëzuar në ora 15:56 mirëpo supozojmë që sistemi i e-prokurimit e ka vonuar.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit dhjetë mendon se është i qëndrueshëm.

SI konkludim, Ekspertja Shqyrtuese sa i përket ankesës së OE ankuesit "Construmax" SHPK sqaron se pretendimet e të njëjtit gjenden të bazuara.

Po ashtu AK rekomandohet që vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ta bëj konform LPP_së dhe Rruopp-së, dhe nëse mendon se asnjë ofertues nuk i plotëson kriteret pra të pa përgjegjshëm atëherë me që rast të eliminimit të ofertuesve të ju përshkruhen më detjaishtë arsyet e eliminimit, në mënyrë që edhe ofertuesit të pajtohen me vendimin.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankuesve të aprovohen si të bazuara, gjersa vendimi i AK-së mbi anulimin e Aktivitetit të Prokurimit të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Matcal Solutions" SHPK, me datë: 30.11.2020 anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

OE construmax nuk e paska lexu deklaratën e konzorciumit se kush është lider. Shumë çart aty shkruan se Lider është kompania Sh.Drini Company sh.p.k.

Operatori Ekonomik "Construmax" SHPK, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Kundërshtojm piken e ekspertizes lidhur me referencat te Matcal solution, për arsye qe kërkesa ne dosjen te tenderit ka qen 60% me plotësu referencat Lideri i grupit , ku ne ketë rast lideri i grupit nuk ka asnjë referencë mirëpo ka prezantua vetëm referenca te partnerit te Konzorciumit, "Drini Company", dmth eshte i papërgjegjshëm.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Matcal Solutions" SHPK, se është eliminuar padrejtësisht dhe se

pretendon se është e përgjegjshme, ku AK e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e plotëson kriterin për projekte të natyrës së kontratës në vlerë prej 300,000.00 euro pasi OE ka referenca në vlerën prej 256,891.00 euro.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se AK kishte kërkuar sqarime shtesë sipas vendimit të PSH 654-702/20 nga OE ankuesi, dhe meqë nuk ishte në e-prokurim e bashkangjitur përgjigja e kërkesës për sqarim nga OE, atëherë ekspertja shqyrtues ka kërkuar sqarim nga AK përmes emailit. Në përgjigje të emailit të ekspertës, AK kthen përgjigje duke sqaruar: “kontrata në fjalë është kërkuar dhe është sjellë nga OE në zyren e prokurimit. Kjo kontratë ndodhet në lëndën përkatëse e cila është në shqyrtim në OSHP. Për të iu lehtësu juve punën, pozicionet të cilat janë marrë sit ë natyrës së kontratës janë të markuara me ngjyrë në këtë kontratë”. Më tej, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se AK përmes emailit ka sqaruar se OE ankuesi ju ka përgjigjur kërkesës për sqarim dhe i njëjti ka dërguar fizikisht dëshmitë e kërkuara: “Paramasën për kontratën me nr 632-16-081-511- Ndërtimi i rrugës Bujar Roka”, ku AK ka vlerësuar se nuk i plotëson kriteret kontrata. Mirëpo, Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se gjatë shqyrtimit dhe analizimit të paramasës së kontratës, kjo kontratë/paramasë i plotëson kriteret, andaj duhet AK që të bëjë edhe njëherë rivlerësimin e ofertave dhe të vlerësoj në detale dhe paramasat.

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit të dytë “Construmax”SHPK: Paneli Shqyrtues sqaron se gjatë shqyrtimit të ankesës tij ka ndodhur një gabim teknik gjatë shkarkimit të ofertave nga e-prokurimi, ku dëshmitë nuk janë vërejtur dhe OSHP ka shqyrtuar ankesën me gjysmën e dokumenteve. Si pasojë e mbajtjes së seancave dëgjimore pa praninë e palëve për shkak të pandemisë “Covid-19”, ky keqkuptim/devijim i cili ka vazhduar deri në vendim, derisa në këtë ankesë, ankuesi na ka sqaruar se edhe ku mundemi me i gjetë dëshmitë në ofertë. OE ankuesi është i eliminuar me arsyetimin:

- të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper
- një eskavator I tonazhit të mesëm deri 10 ton (eskavator ton i madh)
- OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhuesi distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimit sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

Pretendimi i parë i OE ankues është:

Pretendimi 1: Kompania jonë supozon që nuk qëndron arsyeja e eliminimit të kompanisë tonë kinse nuk kemi në pronësi pajisje teknike së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 - 10 tonë me kiper, Kompania jonë ka dorëzuar së bashku me dokumentacionin e ofertës tek **folderi 7.1 Makineri**

Imri Krasniqi — Libreza e kamioni me tonazh 8.2 tonë me regjistrim deri 04.09.2020 (hapja e

ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Isuf Misini - Libreza e kamioni kiper me tonazh 8.1 tonë me regjistrim deri 31.07.2020 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Ebk shpk- Libreza e kamioni kiper me tonazh 5.05 tonë me regjistrim deri 06.05.2021 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Shaban Aliu - Libreza e kamioni kiper me tonazh 5.57 tonë me regjistrim deri 20.06.2021 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Andaj, arsyeja e eliminimit është totalisht e pabazë, pasi që jo vetëm që ne i kemi 4 kamion a ndërsa kërkesa ka qenë 2 kamion dmth dyfishin e kërkuar plotësojmë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se gjatë shqyrtimit të pretendimit në ofertën e OE ankues, tek folderi 7.1 Makineritë sqaron se e plotëson kriterin - dy kamion të tonazhit 5 10 ton me kiper. Andaj, pretendimi gjendet i bazuar. Në vijim janë paraqitur dëshmitë vetëm për dy kamion siç kërkohet në FDT, gjersa OE ka edhe të tjerë siç pretendon më lartë:

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues "Construmax", ku pretendon: kompania jonë supozon që nuk qëndron arsyeja e eliminimit të kompanisë tonë kinse nuk e kemi një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton (eskavator ton i madh), pasi që është dorëzuar me ofertë tek folderi 7. Makineria - seti Comercv-6.2 Bagerat 5 cope- ku brenda kësaj fajlli në faqen e 16 është dudi doganor me nr reference doganore R 11616 që dëshmon Eskavator i perd me zingjir gime me peshë 5.5 tonë i tipit VQLVO tipi EC55B viti i prodhimit 2006. Andaj arsyeja e eliminimit është totalisht e pabaze, pasi që përpos disa ekskavatorëve të dëshmuar kemi ofruar edhe dëshmi që kemi edhe eskalator prej 5.5 tone i prodhimit Volvo tipi EC 55 B 2006.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se në ofertën e tij tek follderi 7. Makineria, sqaron se ky pretendim gjendet i bazuar, me faktin se gjendet Dudi doganor faqe 16 tek Seti Commerce 6.2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, ku potencon: Kompania jonë supozon që nuk qëndron arsyeja e eliminimit të kompanisë tonë kinse OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Kompania jonë ka dorëzuar së bashku me oferte folderin 9. Autorizimi nga prodhuesi - ku mbrenda është Autorizimi nga prodhuesi Europa shpk me NIPT J62903258L nga Shqipria ku jemi autorizu nga ky prodhues që ka dëshmuar në autorizimin e tij që është i certifikuar më këto standarde dhe koperon më kompani tjera ndërkombëtare më standarde tjera. Andaj konstatojmë që ne kemi ofrua dëshmi Autorizimin e Prodhuësit sipas kërkesës në dosje të

tenderit, ndërsa në rast që Autoriteti Kontraktues ka dashur dëshmi tjera shitesë do të duhej konform nenit 72 të kërkoj sqarime edhe pse ka pasur dëshmi të mjaftueshme që kemi autorizim nga prodhuesi me këto standarde.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se në ofertën e tij tek follderi 9 gjendet Autorizimi nga prodhuesi, andaj pretendimi gjendet i bazuar dhe se AK rekomandohet që gjatë procesit të rivlerësimit të verifikoj me kujdes certifikatat sipas FDT-së.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Construmax" SHPK, se OE NNT Etniku nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së tek Kapaciteti teknik dhe profesional. Ky OE është i përgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar dëshmi që ka në pronësi ose posedim këto pajisje teknike: a) së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper b), një eskavator I tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda të cilat nuk janë adekuate për këtë projekt. Gjithashtu ky OE nuk ka prezantuar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461, mirëpo ka prezantuar një marrëveshje për të cilën nuk ka dëshmi që është Kompani e certifikuar apo distributor, andaj edhe është i përgjegjshëm dhe Pajtohem me arsyen e AK-së për eliminimin e këtij OE.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankuesit lidhur me OE NNT Etniku, konsideron se pretendimet janë të qëndrueshme për faktin se në ofertën e OE Etniku kërkesa 3 tek kapacitetet teknike dhe profesionale nuk i plotëson kriteret pasi që kamionët/eskavatorin i ka jashtë kriterit të FDT-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Construmax" SHPK, se OE N.N. " Injineri MSH " TOSI - V " SH.P.K. është i përgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ky OE ka kryer punime te ngjashme 60% të vlerës si lider. Po ashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi që ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a). së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper b). një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda që nuk janë adekuate për këtë projekt. Ky OE është i përgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. OE ka paraqit vetëm një a test te materialit në një kompani që nuk i ka certifikatat të cilat janë kërkuar dhe pajtohem me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE. Gjithashtu ky OE është i përgjegjshëm edhe për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkesë ka qenë "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qene prej jo më

pak se 400.000,00 €", ndërsa si dëshmi është kërkuar "Pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës." Lideri i konzorciumit të lartpërmendur nuk i ka ofruar dëshmitë se e plotëson këtë kërkesë andaj edhe është i papërgjegjshëm.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se pretendimet e OE ankuesit për OE NNT "Inginiering MSH" "Tosi-V" SHPK, sa i përket Lista e punimeve të ngjashme si lider, lideri ka bashkangjitur një listë me shumën 287,555.44 Euro, mirëpo punimet nuk janë ngjashme. Po ashtu, pajisjet si kamionët i ka nën dhe mbi tonazhin dhe njëra pa regjistrim, eskavatori nuk ka DUD, andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Construmax" SHPK, se OE "Puna" Sh.p.k nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së tek Kapaciteti teknik dhe profesional. Ky OE është i papërgjegjshëm për faktin se ky OE nuk i ka ofruar dëshmitë në lidhje me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit. Gjithashtu, ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kryer punë të ngjashme sipas kërkesës së dosje të tenderi edhe pse ka paraqitur disa referenca private, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi bankare që janë ekzekutuar vlerat e tyre. Po ashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi se ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike **a.** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper **b.** një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda të cilat nuk janë adekuate për këtë projekt. OE i lartcekur nuk e ka ofruar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Ky OE ka paraqitur vetëm një a test të materialit nga një kompani që nuk i posedon certifikatat e kërkuara dhe pajtohem me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se pretendimin e OE ankues për OE "Puna" SHPK e konsideron të qëndrueshëm me faktin se tek kërkesa 3 Kapacitetet Teknike Profesionale, pajisjet i ka mbi tonazhin. Po ashtu, edhe kërkesën për autorizimin nuk i posedon sipas kritereve.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues "Construmax" SHPK, se OE N.T.P; B-Ademaj është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshjet e prezantuara për stafin profesional i ka të paraqitura për një projekt tjetër "Ndërtimi i objektit të ri të shkollës në fshatin Pllanjanë. Gjithashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi se i ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisjeteknike **a.** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton³. me kiper **b.** një eskavator 1 tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda që nuk janë adekuate për këtë projekt. Ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ka të paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga

materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461 dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues për OE NTP "B-Ademaj" është i bazuar pasi që oferta e OE "B-Ademaj" nuk e plotëson kërkesën 3 tek Kapacitetet teknike dhe profesionale.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Construmax" SHPK, se grupi i operatorëve ekonomik "Matcal Solutions & Drini Company" është i përgjegjshëm pasi që nuk ka dëshmi që e plotëson kërkesën në dosje të tenderi „Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës" dhe bartësi I grupit nuk ka arrit të dëshmoj asnjë referencë.

Po ashtu ky GOE nuk ka dëshmi as që e plotësojnë vlerën e referencave prej 300.000 € dhe pajtohemi me eliminimin e këtij konzerciumi nga AK-ja.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues kundër GOE "Matcal Solutions dhe Drini Company" nuk qëndron për faktin se Lideri i grupit ka bashkangjitur në ofertën e tij listën e punëve të ngjashme, mirëpo nuk është e pranuar si e mirëqenë nga AK.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Construmax" SHPK, se të gjithë OE tjerë janë të përgjegjshëm dhe pajtohemi me eliminimin e tyre nga AK-ja.

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm. Lidhur me pretendimin e OE ankues "Construmax" SHPK, se me dt. 09.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka hedhur poshtë si e jashtë afatshme është e paqëndrueshme pasi që ne kemi dërguar kërkesën për rishqyrtim me datë 04.11.2020 në ora 15:56 ndërsa sistemi nëse e ka vonuar procesimin duhet sqaruar nga e-prokurimi, edhe pse Autoriteti Kontraktues ka mundur të shqyrtoj kërkesat për rishqyrtim pasi që nuk është e cekur në nenin 108/A ditë pune mirëpo kërkesa për rishqyrtim duhet të bëhet mbrenda 5 dite pas Vendimit që dmth që ditë kalendarike që përfundojnë në orën 0:00 dhe ka pasur afat kohor edhe 8 orë. Edhe nëse do të llogaritej ditë pune atëherë kemi pasur afat edhe 2 ditë tjera për arsye të ditës së shtune dhe të diel. Andaj, bazuar që kërkesa për rishqyrtim konform nenin 108/A duhet të bëhet më së largu 5 ditë pas Vendimit, me të pa drejt AK ka hudhur si të jashtëafatshme kërkesën për rishqyrtim. Andaj nuk ceket ditë pune e as ora mirëpo ceket 5 ditë pas datës, që dmth data ndërrohet në ora 00:00 (12:00 i mbrëmjes) dhe kemi pasur afat deri në orën 00:00 edhe pse ne kemi dorëzuar në ora 15:56 mirëpo supozojmë që sistemi i e-

prokurimit e ka vonuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese sqaron se ky pretendim është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se në ankesën paraprake të OE ankues “Construmax” Sh.p.k. janë lëshuar gabime nga OSHP-ja për shkak të shqyrtimit të ankesës me dokumentacion jo të plotë si pasojë e gabimit teknik gjatë marrjes së dokumentacionit nga e-prokurimit. Andaj, pas sqarimeve të OE ankues “Construmax”SHPK dhe shqyrtimit të shkresave sipas kësaj ankesë për këtë aktivitet të prokurimit, konsideron se pretendimet e këtij operatori ekonomik janë të bazuara. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se AK gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve duhet që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, dhe të bëjë vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK “KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT”;

1x1 OE “Matcal Solutions”SHPK dhe OE “Construmax”SHPK;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.